

VENDIM
Nr. 34, datë 19.1.2022

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2022, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA NR. 1

PLANI I TË ARDHURA-SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2022, PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

000/lek

Të ardhurat		Shpenzimet	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	135,000	Shpenzime personeli	52,000
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	5,100	Shpenzime operative dhe korrente	21,240
Marrëveshja e Madridit	70,000	Transferta korrente të jashtme	20,000
Marrëveshja e Hagës	1,100	Shpenzime kapitale	90,400
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP	250	Totali i shpenzimeve	183,640
		Teprica derdhje në buxhetin e shtetit	27,810
Totali i të ardhurave	211,450	Totali i shpenzimeve dhe teprica në buxhetin e shtetit	211,450